

<p style="text-align: center;">AKT THEMELIM DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “Marine Data Cloud” SHPK</p>	<p style="text-align: center;">ACT OF ESTABLISHMENT AND STATUTE OF LIMITED LIABILITY COMPANY “Marine Data Cloud” SHPK</p>
<p>Sot më datë 20.05.2024 Tiranë, si themeluese me të dhënat e mëposhtme: Unë Znj. Rozafa DJEPAXHIJA qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, e datëlindjes 25.03.1986, rezidente në Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.pasaporte :BR1014022 dhe Nr. Personal ID: I65325078S madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, kam vendosur të nënshkruaj Statutin dhe akt themelimin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky dokument.</p>	<p>Today, on 20.05.2024 Tirana, as founder with the following data: I, Mrs. Rozafa Djepaxhija Albanian citizen, born in Tirana, born 25.03.1986, resident in Albania, holder of passport with no. BR1014022 and No. Personal ID: I65325078S and with full legal capacity to act, I have decided to sign the Statute and the following establishment of a limited liability company, whose activity is regulated by Albanian legislation in power and this document.</p>
<p style="text-align: center;">KREU I FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER I FORM, NAME, OBJECT, DURATION, HEADQUARTERS</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1 – Forma</p> <p>1.1 Shoqëria “Marine Data Cloud ” Shpk (në vijim “Shoqëria”), krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.</p> <p>1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.</p> <p>1.3 Akti i themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1 – Form</p> <p>1.1 The Company "Marine Data Cloud" Shpk (hereinfor "The Company"), is created in the form of a limited liability company, and its activity is regulated by this Statute and the Act of Establishment.</p> <p>1.2 The Company acts according to the Albanian legislation in force.</p> <p>1.3 The Establishment Act and the Statute are in accordance with the Albanian legislation that has a compulsory character, while the issues that are not expressly provided for in them are regulated by Albanian legislation.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2 – Emërtimi</p> <p>2.1 Emërtimi i Shoqërisë është “Marine Data Cloud ” Shpk.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 – Designation</p> <p>2.1 The company's name is "Marine Data Cloud" Shpk.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3–Objekti i shoqërisë:</p> <p>3.1 Aktivitet në fushën e teknologjisë së informacionit IT-së,veçanërisht për zhvillimin e software-it,kërkimit dhe zhvillimit të IT-së.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3–Object of the company:</p> <p>3.1 Activity in the field of IT information technology, especially for software development, research and development of IT.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 4 – Selia</p> <p>4.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. "Ndreko Rino", Apartament Nr.pasurie 7/220+1-63 Zona Kadastrale Nr.8270 , Nr. ap: 63, Tiranë.</p> <p>4.2 Transferimi i Selisë së shoqërisë në një vend tjetër do të mund të bëhet nga Vendimi i Asamblesë së Ortakëve.</p> <p>4.3 Asambleja e Ortakëve do të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe zyrave përfaqësuese në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 4 – Headquarters</p> <p>4.1 The company's headquarters are at: Rr. "Ndreko Rino", Apartment No. 7/220 + 1-63 Cadastral Zone No.8270 , No. ap: 63, Tirana.</p> <p>4.2 Transfer of the Company Headquarters to another country may be made by the Decision of the Association Assembly.</p> <p>4.3 The Assembly of Associates shall decide the opening of subsidiaries, branches and representative offices in other cities of Albania and abroad.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 – Kohëzgjatja</p> <p>5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është me afat të papërcaktuar.</p> <p>5.2 Ndryshimi i afatit të kohëzgjatjes së veprimtarisë së shoqërisë do të bëhet nga Vendimi i Asamblesë së Ortakëve.</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 – Duration</p> <p>5.1 The duration of the company's activity is of an indeterminate period of time.</p> <p>5.2 The change of the duration of the company's activity will be made by the Decision of the Association Assembly.</p>
<p style="text-align: center;">KREU II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER II FOUNDATIONAL CAPITAL, CONTRIBUTIONS, SEPARATION AND TRANSFER OF QUOTES</p>
<p>Neni 6 - Kapitali themeltar</p> <p>Kapitali themeltar i Shoqërisë i nënshkruar dhe i paguar përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlerë të përgjithshme 100 (njëqind) lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 - Fundamental capital</p> <p>The company's fundamental capital signed and paid is composed of 1 (one) quota, with a total value of 100 (one hundred) ALL, which constitutes 100% of the basic capital.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 – Kontributet</p> <p>7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Znj. Rozafa DJEPAXHIJA, qytetare shqiptare, e cila ofron një kontribut në para të barabartë me 100 (njëqind) lekë. <p>7.2 Sipas kontributeve të mësipërme : Znj. Rozafa DJEPAXHIJA, i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë, në vlerën respektivisht 100 (njëqind) lekë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 - Contributions</p> <p>7.1 Contribution to the capital of the company is provided as follows:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mrs. Rozafa Djepaxhija, An Albanian citizen, who offers a contribution in money equal to 100 (one hundred) ALL. <p>7.2 According to the above contributions: Mrs. Rozafa Djepaxhija belongs to 1 (one) quota, corresponding to 100% (one hundred percent) of the capital of the Company, in the value of 100 (one hundred) all respectively.</p>

<p>Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar</p> <p>8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.</p> <p>8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.</p>	<p>Article 8 – Increase of fundamental capital</p> <p>8.1 The basic capital may be increased without limit at any moment, once or several times, by decision of the Assembly of Associates.</p> <p>8.2 In case of capital increase, all associates have the right to sign the increase in relation to the share of capital owned. If some of the associates do not exercise this right, their shares may be signed by other associates proportionately to the shares of the capital owned by them.</p>
<p>Neni 9 - Zvogëlimi i kapitalit themeltar</p> <p>9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.</p> <p>9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.</p>	<p>Article 9 - Reduction of fundamental capital</p> <p>9.1 The Company may reduce the capital by decision of the Associations Assembly. In any case, the basic capital cannot be reduced below the limits provided by law.</p> <p>9.2 Capital reduction is afforded by each of the associates to the same extent as the capital shares owned by them.</p>
<p>Neni 10 - Transferimi i kuotave</p> <p>10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.</p> <p>10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshem nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.</p> <p>10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftoj ortakët e tjerë, me leter rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar për shitje.</p> <p>10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk</p>	<p>Article 10 - Transfer of quotas</p> <p>10.1 Quotes are freely transferable between the associates.</p> <p>10.2 In case of transfer in any form, both with a reward and without a reward in the broadest sense of the word, including donations in favor of other entities other than the associates, the quotas must be first offered in parable to other associates.</p> <p>10.3 In such case the associate who will transfer his quota must notify the other associates, by letter of the return of reply, of the intention for sale, specifying the price, conditions, modalities, name of the buyer and the transfer deadlines. The right of parable must refer to all quotas offered for sale.</p> <p>10.4 The associates shall have at their disposal 30 (thirty) days from the receipt of the recommended letter, to communicate to the associate transferring the quotas, their intention to exercise the right of receipt or not to be entitled to the payment. If they do not reply to the appointed time, they are</p>

<p>përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.</p> <p>10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e afuara nga ortakë që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.</p> <p>10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht.</p> <p>10.7 Kuotat mund të transferohen për shkak trashëgimie mortis causa.</p>	<p>presumed to have given up their right to reply.</p> <p>10.5 In the event that the offer is accepted by several partners, the quotas offered by the partner transferring the quotas will be shared by the accepting partners, in the same proportion as the quotas they own, unless there is a contrary agreement. In no case may the offeree partially exercise the right of pre-emption.</p> <p>10.6 In case the right of parable is not exercised, the quotas may be transferred to third parties in whole or in part.</p> <p>10.7 Quotas can be transposed due to legacy mortis causa.</p>
<p style="text-align: center;">KREU III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER III ASSEMBLY, ADMINISTRATORS AND ACCOUNTING EXPERT</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11- Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj</p> <p>11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.</p> <p>11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi, dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 - The Assembly of associates and its competencies</p> <p>11.1 The decision-making body of the Company is the Assembly of The Associates.</p> <p>11.2 The Association of Associates is responsible for taking decisions on the following issues: changes to the statute, the appointment and dismissal of administrators, accounting experts and liquidators, the expansion, and reduction of capital, transfer of quotas, distribution of profits, reorganization and breakdown of the company, adoption of balance sheets and any other decisions provided for by this Statute or the relevant legislation.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 - E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës</p> <p>12.1 Cdo ortak ka ta drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.</p> <p>12.2 Cdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 - Right to participation and vote</p> <p>12.1 Each partner has the right to participate in the Assembly, to submit his opinion and to give as many votes as is the number of quotas he owns.</p> <p>12.2 Each partner has the right to be represented by another non-partner, equipped with written proxy, through which he can give his vote.</p>

<p>12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokura për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.</p>	<p>12.3 The associate may not issue voting proxy for a portion of the capital he owns if he votes personally for the remainder.</p>
<p>Neni 13 - Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet</p> <p>13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.</p> <p>13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që parfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje me fax apo telegram që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve - dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 8 (tetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.</p> <p>13.3 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.</p> <p>13.4 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet</p>	<p>Article 13 - Summoning of the Assembly of Associates, Quorum and Decisions</p> <p>13.1 The Assembly of Associates shall be called at least once a year, within six (six) months from the end of the financial year for the adoption of the balance sheet, the report of the Administrator, accounting expert and inventory.</p> <p>13.2 The Assembly may at any time be convened by one of the Administrators and by one or several associates representing at least 5% (five percent) of the foundational capital. The Assembly shall be called by notification by letter of recommendation with a fax or telegram response to be sent to the associates at the address resulting in the Book of Associates - and to the accounting expert (if appointed), at least 8 (eight) days before the meeting of the Assembly. The call shall contain information on the type of Assembly, on the issues to be addressed and on which decision will be taken, on the place, time and date of the first and second call.</p> <p>13.3 If the Assembly of Associates does not meet with the first call for the absence of quorum provided for in point 13.7 of this Statute, the Assembly of Associates shall be convened within thirty (thirty) days with the same agenda.</p> <p>13.4 Meetings of the Assembly may also be held through teleconference and videoconference, provided that all participants can be identified and allowed to attend the discussion and intervene at the moment of addressing issues on the agenda; Once these requirements have been verified, which should result in the minutes of the meeting, the Assembly shall be held in the</p>

<p>Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.</p> <p>13.5 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formalite të vetënjoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.</p> <p>13.6 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.</p> <p>Vendimet e Asamblesë së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.</p> <p>13.7 Asambleja e Ortakëve vendos me shumicë të cilësuar ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të 50%+1 votë të ortakëve të pranishëm. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve të pranishëm.</p> <p>13.8 Cdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.</p> <p>13.9 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.</p>	<p>place where the Chair is located in which the Secretary of the Meeting shall be.</p> <p>13.5 The collection shall be called and held regularly without respect for the formality of self-acknowledgment, if the associates representing the entire foundation capital are present.</p> <p>13.6 The decisions of the Assembly of Associates, for which a simple majority is required, shall be valid if present are present the voting partner who owns more than 50% (fifty percent) of the foundational capital. The decisions of the Assembly of Associates seeking a qualified majority are valid if there are present the right-voting associates who own more than 50% (fifty percent) of the foundational capital.</p> <p>13.7 The Assembly of Partners decides by a qualified majority the changes to the statute, the increase and decrease of the capital, the distribution of profits, the reorganization and the dissolution of the company, with a positive vote of 50% + 1 share of the partners present. In all other cases, the Assembly of Partners takes decisions by a simple majority of votes of the partners present.</p> <p>13.8 Each Assembly is headed by a partner or any other person appointed by the Assembly itself. For reflection of the decision, the Assembly appoints a Secretary, who may also be non-partner.</p> <p>13.9 The assembly's decisions must be signed by the Speaker of the Assembly and the Secretary.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 – Administrimi</p> <p>14.1.1 Shoqëria administrohet nga një administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 vjeçare (pesë).</p> <p>14.1.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha fuqitë konform me</p>	<p style="text-align: center;">Neni 14 – Administration</p> <p>14.1.1 The Company shall be administered by an administrator who shall remain in office until dismissal or resignation or for a period of five years (five).</p> <p>14.1.2 Legal representation of the Company is entrusted to the Administrator. The Administrator may exercise all powers</p>

<p>saparashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.</p> <p>14.1.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posacëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.</p> <p>14.1.4 Administratori nuk ka të drejtë të kryejë veprime në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe veprime të tjera me rëndësi thelbësore për shoqërinë pa miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të përfaqësuar nga Ortakët.</p> <p>14.1.5 Administrator i parë i shoqërisë emërohet Znj. Rozafa DJEPAXHIJA qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, e datëlindjes 25.03.1986 , mbajtëse e letërnjoftimit me nr.pasaporte :BR1014022 dhe Nr. Personal ID : I65325078S.</p>	<p>according to the provisions of Article 95 of Law n. 9901 dated 14.04.2008 "On Traders and Commercial Companies" as amended.</p> <p>14.1.3 The Administrator may appoint specific representatives for certain actions or categories of actions.</p> <p>14.1.4 The Administrator shall not be entitled to carry out acts in respect of the implementation of trade policies and other actions of substantial importance to the company without the approval of the General Assembly represented by the Associates.</p> <p>14.1.5 The first administrator of the company is appointed Mrs. Rozafa Djepaxhija Albanian citizen, born in Tirana, born 25.03.1986, holder of Passport with no. BR1014022 and No. Personal ID: I65325078S.</p>
<p>Neni 15- Eksperti kontabël i autorizuar</p> <p>15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.</p> <p>15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.</p>	<p>Neni 15- Authorized accounting expert</p> <p>15.1 If required by law or decided by the Assembly of Partners, the audit of the balance sheets and accounting books of the Company may be entity with one or several authorized accounting experts.</p> <p>15.2 The authorized accounting expert may be dismissed in the manner provided for by the applicable legislation.</p>
<p style="text-align: center;">KREU IV</p> <p style="text-align: center;">VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE</p>	<p style="text-align: center;">HEAD IV</p> <p style="text-align: center;">FINANCIAL YEAR, ANNUAL BALANCE, DISTRIBUTION OF PROFITS</p>
<p>Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor</p> <p>16.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.</p> <p>16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.</p> <p>16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligjit nr. 9901 të datës</p>	<p>Article 16 - Financial year and annual balance</p> <p>16.1 The financial year starts on January 1st and ends on December 31 of each year.</p> <p>16.2 The first financial year begins on the date of registration of the Company at the National Registration Center and ends on December 31 of the same year.</p> <p>16.3 Annual balance sheets, inventory, reports of the Administrator and authorized accounting expert shall be approved by the Assembly by the majority required by Law</p>

<p>14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".</p> <p>16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.</p>	<p>No. 16.3. 9901 of 14.04.2008 "On Traders and Companies".</p> <p>16.4 Approval of documents relating to the financial year must be made within 6 (six) months since the end of the financial year.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 – Fitimet</p> <p>17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.</p> <p>17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 – Profits</p> <p>17.1 Benefits resulting from the annual balance shall be distributed to the associates in proportion to the shares of the founding capital owned.</p> <p>17.2 The Company may also impose special deductions in favor of exceptional reserves or for other purposes or postponing the distribution of profits, in whole or in part, for future financial years.</p>
<p style="text-align: center;">KREU V SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISË</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER V DISTRIBUTION AND LIQUIDATION OF THE COMPANY</p>
<p style="text-align: center;">Neni 18– Prishja</p> <p>18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.</p> <p>18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 – Liquidation</p> <p>18.1 The company breaks down by the expiry of the term provided by the Statute, either before the termination in cases provided by law, or by a decision of the Assembly of Associates, with the majority required for changes in the statute.</p> <p>18.2 The company shall not be dissolved in the event of loss of the ability to operate, death, or bankruptcy of the partner.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 19 – Likuidimi</p> <p>19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likujdohet.</p> <p>19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit, dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.</p> <p>19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 19 - Liquidation</p> <p>19.1 In case of a breach, the Company shall be liquidated.</p> <p>19.2 In order to administer this procedure, the Assembly shall appoint one or more liquidators who present final reports on the state of the asset and passivity of the Company, on the liquidation operations, and on the time necessary to complete the liquidation.</p> <p>19.3 Upon completion of the liquidation procedure, the Assembly shall decide on the final financial balance, the work carried out by the liquidation and the completion of the liquidation process.</p>

<p>19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.</p>	<p>19.4 After payment of creditors and collection of loans, the liquidator shall distribute the final liquidation proceeds to the partner, in proportion to the shares of the capital owned by them in the foundational capital.</p>
<p>Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe atë që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejte ndërmjet palëve të interesuara. 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, atëherë mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion përkatës.</p>	<p>Article 20 - Resolution of disputes 20.1 All disputes which may arise in connection with the interpretation and/or application of this Statute and the act of establishment, as well as that which may arise generally between the associates (other than those personal or outside the Company) or between one or more of the associates and the Company, shall be resolved in a friendly manner and discussed directly between the interested parties. 20.2 In case there is no amicable resolution of the dispute, then the dispute of the partner shall be resolved by the court with relevant jurisdiction.</p>
<p>Neni 21 –Gjuha 21.1Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.</p>	<p>Article 21 – Language 21.1 This Statute is drafted in 3 (three) copies both in the Albanian and in the English language.</p>
<p>ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË Znj. Rozafa DJEPAXHIJA</p>	<p>SOLE OWNER OF THE COMPANY Mrs. Rozafa DJEPAXHIJA</p>

Rozafa Djepaxhija
